REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 881/20
Datë/Datum. 02.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A. Rr. "Bill Klinton, 10000 Prishtinë**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Vete Financim-20-828-1-1-1**, *Nr i brendshem:* **20-021-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: "**Furnizim me Vajra dhe Yndyrna për Automjete**"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"BALLKAN PETROL" SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

ZONA INDUSTRIALE GËRLICË
(Adresa)

FERIZAJ — *70000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/113 543 — *N/A*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

BEKIM ALITI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@ballkanpetrol.com

02.11.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)
(Nënshkrimi dhe vula)

SHOQËRIA E PËRGJITHSHME E KUFIZUAR Ballkan Petrol Sh.p.k. FERIZAJ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Nuk angazhoj avokat

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Tenderi: **"Furnizim me Vajra dhe Yndyrna për Automjete"**, me nr. prokurimi **Vete Financim-20-828-1-1-1**, nr. i brendshëm: **20-021-1-1-1.**
- 08.04.2020 – Njoftimi për kontratë
- 27.04.2020 - Afati i fundit për pyetje sqaruese
- 24.04.2020 – Kërkese për sqarimin e dosjes së tenderit
- 30.04.2020 – Përgjigjet në kërkesat për sqarime të DT
- 05.05.2020 – Kërkesë për rishqyrtim
- 07.05.2020 – Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim – refuzim
- 08.05.2020 – Kërkesë për rishqyrtim
- 13.05.2020 – Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim – refuzim
- 18.05.2020 – Ankesë në OSHP nga OE "Inter Trading" shpk
- 15.06.2020 – Vendimi i OSHP-së nr. **310/20** – ri-vlerësim
- 03.07.2020 – Dosja e tenderit e korrigjuar no. 1
- ??.07.2020 – Kërkesë për rishqyrtim nga OE "Inter Trading" shpk
- 14.07.2020 – Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të OE "Inter Trading" shpk – refuzim
- 14.07.2020 – Dosja e tenderit e korrigjuar no.2
- 18.07.2020 - Kërkesë për rishqyrtim
- 22.07.2020 – Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim – refuzim
- 22.07.2020 – Dosja e tenderit e korrigjuar no.3
- 24.07.2020 - Kërkesë për rishqyrtim
- 28.07.2020 – Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim – refuzim
- 30.07.2020 – Ankesë në OSHP
- 04.09.2020 - Vendimi i OSHP-së nr. **520/20** – ri-vlerësim
- 14.10.2020 – Dosja e tenderit e korrigjuar no.4
- 19.10.2020 – Kërkesë për informacione shtesë
- 22.10.2020 – Dosja e tenderit e korrigjuar no.5
- 28.10.2020 – Kërkesë për rishqyrtim
- 29.10.2020 - Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim – refuzim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ Jo ☒

- 28.10.2020 - Kërkesa për rishqyrtim në AK
- 29.10.2020 - Vendimi per refuzim i kerkeses per rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, paragrafi 2
Neni 28 Specifikimet Teknike, paragrafi 1, 2 dhe 7
Neni 53 -Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit
Neni 109 – Afatet për dorëzimin e ankesës

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Hyrje:

- Pas vendimit të OSHP nr. 510/20, dt.04.09.2020, AK me datë 14.10.2020 ka bërë korrigjimin e specifikacioneve teknike të dosjes së tenderit. Specifikacionet e korrigjuara kanë pësuar disa ndryshime, por prap janë përpiliuar në formë diskriminuese, me ç'rast ka patur nevojë që të sqarohen me AK.

Në dosjen e korrigjuar, pjesa administrative (FDT) e dosjes së tenderit, përpos datës së dorëzimint të ofertave, ka mbetur e pandryshuar.

Me datë 19.10.2020, përmes formës standarde të kërkesës për sqarimin e dosjes së tenderit kemi kërkuar nga AK që të na jep një afat për parashtrimin e kërkesës për sqarimin e dosjes së tenderit, me qenë se specifikacionet teknike kanë pësuar ndryshime.

Pas nuk morëm përgjigje nga AK, me datë 28.10.2020 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim.

Me datë 29.10.2020, AK ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim

Në vendimin për refuzim (pa nënshkrim dhe vulë) AK na e ka mohuar *"Këshillën Juridike"* për ankesë në OSHP konform nenit 109 të LPP-së.

Me datë 30.10.2020 përmes emailit i kemi bërë me dije AK për mos zbatim te nenit 109 të LPP dhe me qenë se nuk pati një reagim nga AK, ishim të detyruar të parashtrojmë ankesë në OSHP.

Pretendimet tona:

- Ju bëjmë me dije se AK ka bërë shkelje në vazhdimësi të procedurave të ligjit të prokurimit.
Është hera e pestë që është ndryshuar dosja e tenderit me ç'rast kanë ndryhuar edhe specifikimet teknike të detyrueshme dhe nuk është lënë hapësirë për sqarimin e dosjes. Pra që në start vazhdimisht AK ka shkelur ***Nenin 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit***

- Ju bëjmë më dije se për këtë aktivitet të prokurimit dy herë ka pasur ankesë në OSHP (vendimi nr. 310/20 dhe 520/20) dhe të dy vendimet e dala nga OSHP-ja OBLIGON AK ti përmirëson specifikacionet teknike në atë mënyrë që të jenë sa më gjithpërfshirëse dhe mos të ketë diskriminim për OE që shprehin interesim të ofertojnë. Njëherit ka obliguar që specifikacionet teknike t'i kërkoni në bazë të automjeteve që posedon AK.

- Edhe pse AK ka për OBLIGIM ti zbatoj vendimet e OSHP-së si organ më i lartë i Prokurimit në Republikën e Kosovës, AK prap ka vazhduar me avazin e vjetër dhe ka aplikuar specifikacione diskriminuese dhe të panevojshme vetëm që të favorizohet një prodhues i caktuar dhe OE tjerë ti pamundësojnë pjesëmarrjen.

- Ne si prodhues të vajrave dhe njohës të kësaj lëmie, haptas vërejmë tendencën e AK se ka një operator të caktuar, të cilin mendojmë se ose e favorizon ose ju ndihmon t'i përpilon specifikat në atë mënyrë që të përjashtojnë pothuaj të gjithë prodhuesit e vajrave.

- Një shembull shumë i thjeshtë:
Për produktin nr. 10, Antifriz G-12, AK ka kërkuar aprovim nga SHKODA, kërkesë e cila vetëm për një laik nuk nënkupton se është kërkesë e panevojshme dhe diskriminuese.
Me sa kemi njohuri nga kontratat për furnizimet e mëhershme, pjesa dërmuese e automjeteve që AK posedon janë kamiona për bartjen e mbeturinave dhe marka SHKODA nuk ka të bëj absolutikisht me paisjet që posedon AK.

- Fakti tjetër diskriminues dhe i pa arritshëm është se për secilin produkt ka kërkuar:
Aftati I prodhimit jo me vone se 6 muaj ose skadenca minimumi 4 vite e shkruar ne ambalazhim nga prodhuesi.
Produkti duhet te kete tape te dyfishte
Është absurde të kërkohet që produkti të ketë tapë të dyfishtë kur pothuajse asnjë prodhues nuk aplikon tapë të dyfishtë për ambalazhimet e tyre në paketim 10L ose me çfarë logjike është kërkuar këtë kriter për yndyrë kur dihet se yndyra zakonisht ofrohet në kanta metali ose plastike dhe tapa e dyfishtë është e paarritshme për thuajse të gjithë prodhuesit.

- Për pozicionin 5 Vaj motori SAE 5W-40 janë kërkuar 4 aprovime, MB 229.51, Ford WSS-M2C917-A, Fiat 9.55535-S2 dhe Fiat 9.955535-H2.
Është e palogjikshme që për një produkt të vetëm të kërkohen aprovime nga shumë prodhues të automjeteve Mercedes Ford, Fiat.
Nëse hulumtohen certifikatat e prodhuesve më të njohur botëror të vajrave, për vajin me gradacion 5W-40 tek asnjëri prodhues nuk mund të gjindet ndonjë produkt i cili ka shumë aprovime për të njejtin produkt (bashkangjitur disa nga certifikatat e prodhuesve Castrol, Shell e Texaco ku çartë shifet se asnjëri nuk i ka të gjitha 4 aprovimet që i keni kërkuar për vajin SAE 5W-40).

- Për pozicionin nr. 11, yndyrë për lubrifikim, është kërkuar aprovim nga MAN dhe MB.
Gjatë përvojës shumëvjeqare, asnjëherë nuk kemi pasur rast që një AK të kërkon aprovime për yndyrë siq është vepruar me këtë rast. Ky është edhe një dëshmi shtesë se po favorizonet një

prodhues të caktuar. Ky kriter është tërësisht i panevojshëm dhe diskriminues për shumë prodhues.

- Ju bëjmë me dije se asnjëherë aprovimi nuk e përcakton cilësinë e vajit, por janë specifikacionet dhe parametrat fiziko-kimiko ata që përcaktojnë cilësinë e secilit vaj.

- Neve na ka rastisur që shpesh ti shofim kamionët e AK nëpër rrugët e regjionit të Prishtinës dhe kemi vërejtur se shumica prej tyre janë të markës ISUZU dhe nëse do të ishte kërkuar ndonjë kërkesë specifike për ISUZU do të ishte e arsyeshme, por të kërkohen aprovime për Renault, Shkoda, Mercedes Benz, etj. automjete që fare nuk i posedon AK, kjo është thjesht diskriminim dhe nuk don koment.

- Ju bëjmë me dije se kompania jonë ka kontrata për furnizime me vajra pothuajse me të gjitha kompanitë rajonale të mbeturinave dhe asnjëherë furnizimet tona nuk paraqesin problem për ta edhe pse kanë makineri të ngjajshme me kompaninë tuaj, andaj është për tu habitur se cili është qëllimi i AK që këtë aktivitet e zvarrit pa nevojë për një kohë mjaft të gjatë.

Bazuar në faktet e lartë cekura kërkojmë nga OSHP që të nxjerr:

VENDIM

Të OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues ta pezulloj këtë aktivitet prokurimi, ta shtyej datën për hapjen e ofertave dhe ti përmirësoj specifikacionet teknike dhe t'u mundësohet Operatorëve Ekonomik të bëjnë sqarimet eventuale të dosjes së tënderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. *B05 Njoftim per Kontrat, 08.04.2020*
2. *Specifikimet teknike me korrigjime - 22.10.2020*
3.
4. *Vendimi i OSHP 310-20, 15.06.2020*
5. *Specifikimet Teknike fillestare-Shqip, 14.05.2020*
6. *Specifikimet teknike me korrigjime-Shqip, 22.07.2020*
7. *Specifikimet teknike me korrigjime-Anglisht, 22.07.2020*
8. *Kerkese per rishqyrtim ne AK 18.07.2020*
9. *Pergjigja e Kerkeses per Rishqyrtim, 22.07.2020*
10. *Kerkese per rishqyrtim ne AK, 24.07.2020*
11. *Pergjigja e Kerkeses per Rishqyrtim, 28.07.2020*
12. *Certifikatat AVISTA*
13. *Urdherpagesa dhe fletepagesa*
14. *Specifikimet teknike me korrigjime-22.10.2020*
15. *Certifikata Castrol Megnatec Professional C3 5W-40*

16. Certifikata Castrol Megnatec 5W-40 C3
17. Certifikata SHELL Helix HX7 ECT 5W-40
18. Certifilata Chevron Havoline ProDS LE 5W-40

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*